



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
GJYKATA KUSHTETUESE  
KOLEGJI I POSAÇËM I APELIMIT

Nr. 21/2020 (JR)  
Nr. 21/...regj.

Tiranë, më 09.11.2020

**SHPALLJE  
E  
NJOFTIMIT PËR GJYKIMIN E ÇËSHTJES NË SEANCË PUBLIKE**

Nëpërmjet kësaj shpallje, Kolegji i Posaçëm i Apelit, bazuar në nenin 65, pikat 1 dhe 3 të ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, njofton subjektet pjesëmarrëse në proces, si dhe të gjithë personat e interesuar se ditën e **mërkurë, në datën 09.12.2020, ora 10:00**, do të gjykohet në seancë gjyqësore publike çështja e Juridiksionit të Rivlerësimit, me numër regjistri 21/2020 (JR), datë 26.06.2020, për ankimin që Komisioneri Publik ka bërë kundër vendimit nr. 249, datë 06.03.2020, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, për subjektin e rivlerësimit Piro Samara.

Seanca gjyqësore publike do të zhvillohet në selinë e Kolegjit të Posaçëm të Apelit, në adresën Bulevardi “Dëshmorët e Kombit”, Nr. 3, Tiranë.

Trupi Gjykes përbëhet nga gjyqtarët:

<b>Kryesuese e Trupit Gjykes</b>	<b>Rezarta Schuetz</b>
<b>Relatore e Çështjes</b>	<b>Ina Rama</b>
<b>Gjyqtare</b>	<b>Albana Shtylla</b>
<b>Gjyqtar</b>	<b>Ardian Hajdari</b>
<b>Gjyqtare</b>	<b>Natasha Mula</b>

Bazuar në nenin 460 pika 5 e Kodit të Procedurës Civile kjo shpallje bëhet të paktën 15 ditë para seancës së gjykimit, në ambientet e Kolegjit të Posaçëm të Apelit dhe në ambientet e Komisionit të Pavarur të Kualifikimit. Ky njoftim bëhet gjithashtu edhe në faqen e internetit të Kolegjit të Posaçëm të Apelit, në faqen e internetit të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, si dhe me njoftim individual në të dhënat e kontaktit të subjektit të rivlerësimit të deklaruar në Komisionin e Pavarur të Kualifikimit, si dhe të dhënat elektronike të Institucionit të Komisionerëve Publikë.

**KRYESUESE E TRUPIT GJYKUES  
GJYQTARE**

  
**REZARTA SCHUETZ**

